



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government

*Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë- Ministarstva za Obrazovanje Nauku i
Tehnologiju-Ministry of Education Science & Technology*

Kabineti i Ministrit/Kabinet Ministra/ Cabinet of the Minister

**ANEKS –I- I UDHËZIMIT ADMINISTRATIV nr. 3/2010 të dt. 16.04.2010
për verifikimin e diplomave dhe dokumentacionit tjetër të lëshuar nga BPrAL**

NUMËR:10/2010

DATË: 29.07.2010

Në bazë të nenit 93 (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, neneve 4.1(d), 12.2, 12.6 dhe 12.7 të Ligjit mbi Arsimin e Lartë në Kosovë 2002/03, dhe nenit 25 paragrafit 7 të Rregullores së Punës të Qeverisë së Kosovës nr.1/2007, Udhëzimit administrativ për Licencimin e Bartësve Privat të Arsimit të Lartë nr.14/2003; UA Libri amëz i studentëve të institucioneve private nr.21/2006 dhe UA për diplomën dhe shtojcën e diplomës nr.38/2008, Ministria e Arsimit,e Shkencës dhe e Teknologjisë (MASHT), nxjerr këtë Aneks –I- të Udhëzimit administrativ nr. 3/2010.

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i këtij Aneksi -I – të Udhëzimit administrativ nr. 3/2010 është plotësimi i nenit 5 paragrafit 1 me nënparagrafin 1.1.

Neni 2

Plotësohet neni 5 paragrafi 1 të cilit i shtohet nënparagrafi 1.1, i cili do të ketë këtë përmbajtje:

Të gjitha diplomat dhe dokumentet e tjera nga programet e studimit të zhvilluara para vitit akademik 2007/2008, të cilat kanë filluar pa u pajisur me licencë dhe e njëjta iu është dhënë në vitet vijuese të studimit, konsiderohen të licencuara.

Neni 3

Hyrja në fuqi

Ky Aneks -I- i Udhëzimit administrativ nr. 3/2010 hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të tij .



Enver Hoxhaj, ministër